

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: Avni Murtezi B.I., Jakup Ferri – PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	03.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **02.01.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Avni Murtezi B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2023/2024**, me Numër të prokurimit: **623-23-13234-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-078-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Avni Murtezi B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2023/2024**, me Numër të prokurimit: **623-23-13234-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-078-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **28.12.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-23-13234-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-078-1-2-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Avni Murtezi B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2023/2024**, me Numër të prokurimit: **623-23-13234-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-078-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **28.12.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **02.01.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET E TUA ANKIMORE:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit ***B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar***, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit;

Dëshmia 3: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.).

Vëmendje!

Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për këto pajisje:

Kamion kiper, me peshë bartëse deri 5m³ – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion për bartjen e Kontinerëve me 2 dyer, tabela Nr. 01-219-ZE, me peshë bartëse mbi 14m³ (14191);

Kamion, me peshë bartëse **deri 3m3** – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion me 2 dyer, tabela **Nr. 01-941-LC**, me peshë bartëse **mbi 8m3 (8940)**;

Kamion me vinç, me peshë bartëse **deri 8m3** – në ofertën e juaj të prezantuar për këtë pajisje keni paraqitur: Kamion me vinç me 2 dyer, tabela **Nr. 01-861-UB**, me peshë bartëse **mbi 10m3 (10600)**;

Nuk e keni plotësuar këtë kriter sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit